

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar kolegjii, Rafet Haxhaj dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit “Ex Fis” Sh.p.k, me seli në Vrellë-Lipjan, të cilën me autorizim e përfaqëson N.T. nga Prishtina, kundër të paditurës Ngrohtorja e Qytetit të Gjakovës-Gjakovë, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati Sh.B. nga Prishtina, për shkak të pagesës së borxhit në emër të kamatës për vonesë, në shumën prej 85,680.20€, duke vendosur lidhur me duke vendosur lidhur me ankesat e paditësit dhe të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore – Departamenti për Çështje Ekonomike, III.C.nr.638/13, të datës 11.11.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt. 05.09.2017, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHEN** si të pabazuara ankesat e paditësit dhe të paditurës, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore – Departamenti për Çështje Ekonomike, III.C.nr.638/13, i datës 11.11.2015, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditësit “Ex Fis” Sh.p.k., ashtu që në paragrafin I. ka detyruar të paditurën Ngrohtorja e Qytetit të Gjakovës, që paditësit në emër të kamatës për vonesën e pagesës së borxhit kryesor, për periudhën 02.11.2010 e deri më datën 24.12.2012, t’ia paguaj shumën prej 29,385.16€, e llogaritur sipas normës 3.5%, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit së këtij aktgjykimi, në paragrafin II. ka refuzuar si të pabazuar pjesën e kërkesëpadisë lidhur me llogaritjen e kamatës prej 10%, ndërsa në paragrafin III. ka detyruar të paditurin që paditësit në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia paguajë shumën prej 413.00 €.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë paditësi për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj ashtu që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit në shumën prej 83,956.80 € apo që i njëjti t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje, duke i’u njohur të gjitha shpenzimet procedurale duke përfshirë edhe shpenzimet e përpilimit të kësaj ankese në shumën prej 416.00 €,

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë edhe i padituri, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, duke propozuar që gjykata e shkallës së dytë të ndryshojë pikën III. të dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, III.C.nr.638/13, të datës 11.11.2015, ashtu që të detyrohet paditësi që të paditurës, t’ia kompensoj shpenzimet procedurale në shumën prej 1,976.00 €, në afat prej 15 ditësh pas marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës , aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK , gjeti se:

### **Ankesat janë të pabazuara.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se, paditësi “Ex Fis” Sh.p.k, me seli në Vrellë-Lipjan, pranë gjykatës së shkallës së parë, ka ushtruar padi me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit për shkak të dëmit dhe vonesave në pagesa t’ia paguaj shumën prej 85,680.20 euro dhe të bëjë të mundur aludimin e mjeteve në afat prej 10 ditësh, me kërkesë që të gjitha shpenzimet procedurale të bien mbi të paditurën.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në provat e lëndës, aneks kontrate për furnizim me mazut Nr.664 e datës 08.10.2010, kontrata me Nr. 663 e datës 08.10.2010, kontrata me Nr.08 e datës 17.01.2012, kontrata me Nr.304/1 e datës 22.10.2012 së bashku me kushtet e përgjithshme të kontratës, pasqyra e faturave nga paditësi për vitin 2010, 2011 dhe 2012, aneks kontrata me Nr.443 e datës 11.11.2011, konfirmimi mbi interesin bankar nga Raiffeisen Bank e datës 18.02.2015, shikimi i faturave për periudhën 2010, 2011 dhe 2012, ekspertiza financiare nga eksperti Vehbi Imeri, plotësim ekspertiza e datës 18.09.2015 si dhe plotësimi i ekspertizës financiare i datës 12.10.2015, ka gjetur se i padituri ne emër të kamatës për vonesën e pagesës së borxhit kryesor për periudhën 02.11.2010 deri me datën 24.12.2012, i ka mbetur borxh paditësit shumën prej 29,385.16 €, e llogaritur sipas normës prej 3.5% dhe mbi këtë bazë, duke aplikuar dispozitat e nenit 277 të LMD-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale sepse dispozitat e nenit 15 dhe 17 të LMD-së, parashohin se palët kontraktuese në marrëdhënie detyrimore kontraktuese janë të obliguara t’i kryejnë obligimet e ndërsjella dhe janë përgjegjës lidhur me përmbushjen e tyre dhe se te kontrata dypalëshe pjesëmarrësit nisen nga parimi i vlerës

së barabartë të dhënieve reciproke. Gjithashtu neni 262 i LMD-së, parasheh se kreditori në marrëdhënie detyrimore ka të drejtë që nga debitori të kërkoj përmbushjen e detyrimit, si dhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për shkak të mospërmbushjes së detyrimit apo vonesës në përmbushje, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi. Andaj në bazë të këtyre dispozitave gjykata ka vlerësuar se ekziston obligimi i të paditurës për pagesën e borxhit në shumën e gjykuar.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e paditëses lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Paditësja gjatë procedurës së shkallës së parë si dhe në ankesë pretendon se asj i takon kamatëvonesa sipas normës vjetore prej 10% por gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me lartësinë e normës së interesit të pranuar, të cilat arsye i pranon plotësisht edhe kjo gjykatë.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi edhe pretendimet ankimore të së paditurës lidhur me shpenzimet procedurale por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse e paditura me mospagesën e detyrimit me kohë, i ka dhënë shkas padisë andaj edhe obligohet t'i paguaj shpenzimet procedurale. Nuk qëndron pretendimi ankimor se paditësja ka pasur sukses vetëm pjesërisht me padinë e saj sepse baza juridike e kërkesëpadisë është plotësisht e bazuar ndërsa lartësia e shumës së aprovuar nuk përcakton suksesin e çështjes.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK .

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,**  
**Ae.nr.24/2016, dt. 05.09.2017**

**KRYETARI I KOLEGJIT,**  
**Mahir Tutuli,d.v.**